

KËRKESË
Nr. 1626, datë 27.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “FED INVEST”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“FED INVEST”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000001-5

Datë: 21.1.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000001-2, datë 4.1.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin FED INVEST, NIPT K82923207C, punëdhënës Elvis Sinani, prej datës 4.1.2019, ora 10:00 deri më datën 4.1.2019, ora 14:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 4.1.2019 dhe e njoftoi në datën 4.1.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", neni 32, pika 1/e,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", datë 1.4.2019, neni/neneve 32, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 5 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Pezullim të pjesshëm të aktivitetit të pajisjeve zhurmëprodhuuese deri në marrjen e masave për mbrojtjen e zhurmave.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ardit Bubeqi ID: 0301020010

Jetnor Zhelegu ID: 0301020017

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti FED iINVEST ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.